Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

TERMAT E REFERENCES

Për Ngritja e Qendres me Sistemet Multiaplikative te Identifikimit Biometrik te personit (AMAI5)".

Aplikimi i qendres AMAIS ka përmirësuar shpejtësinë e përpunimit të informacionit nga Policia Shtetit, si dhe ka standardizuar procedurat ligjore për identifikimin biometrik të personave që janë të përfshirë në aktivitet kriminal dhe janë shpallur në kërkim nga Policia e Shtetit. Ky identifikim biometrik realizohet me anën e imazheve të gjurmëve të gishtave dhe imazheve të fytyrës.

Sistemi administrohet nga Drejtoria e IT të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit dhe sistemi ka një administratore, staf i Drejtorisë të IT dhe serverat e kësaj qendre ndodhet në dhomen e serverëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, që përmbush të gjithë elementet e sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore, rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Kompjuterike (ALCIRT), si ajo për fjalëkalimet, etj. duhet të jenë pjesë integrale në sistem në mënyrë që të lehtësohet dhe automatizohet sa më shumë zbatimi i tyre.

Në funksion të kësaj qendre, Instituti i Policisë Shkencore kërkon të realizojë blerjen dhe instalimin e 12 pajisjeve multifunkionale për mbledhjen e të dhënave biometrike të personave që ndalohen/arrestohen në strukturat e Policisë së Shtetit si dhe 30 cope pajisje portabile të verifikimit dhe identifikimit të personit me anën e gjurmëve të gishtave dhe fytyrës humane, si pjesë përbërëse të qendrës me sistemet multiplikative të identifikimit biometrik të personit AMAIS.

Me realizimin e këtij investimi synohet siguri dhe realizimi i praktikave si më poshtë:

- Identifikimi i shpejtë i të gjithë të ndaluarve/arrestuarve, personave të deportuar, emigrantët e paligjshme me anën e gjurmëve të gishtave të sistemin Afis/Apis dhe me anën e fytyrës në sistemin AFAIS nga pajisjet portabile Biofad.(ekuivalent)
- Krahasoni automatik në sistemin Afis/Apis të gjurmëve të duarve të personave të ndaluar/arrestuar, personave deportiv me qëllim identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve që janë administruar si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.
- Identifikimin e menjëhershëm me gjurmët e gishtave dhe fytyrës të të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalimit Kontrollit me anën e pajisjeve Live skanera dhe pajisjet portabile Biofad.(ekuivalente)
- Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin Afis/Apis të imazheve të gjurmëve të duarve që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim identifikimin e autorit me anën e gjurmëve të gishtave në databazën e këtij sistemi brenda ditës.
- Krijimin e mundësisë për të kaluar në krahasimin automatik të të dhënave daktiloskopike midis sistemit tonë Afis/Apis dhe sistemeve të 11 vendet anëtare të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Evropës Juglindore(PCCSEE) si Austria, Hungaria, Sllovenia, Kroaci, Bullgaria, Rumania, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina dhe Moldavia.
- Identifikimin e menjëhershëm me gjurmët e gishtave të të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalimit Kontrollit.
- Identifikimin e falsifikimeve të kryera në dokumentet e identifikimit, pasapostat e udhëtimit etj me anën e aplikimit të ekzaminimit me anën e burimeve të dritës ultraviolette, infar të kuqe, me kend dhe nga poshte.

-
- Leximin e permbajtes se cipit te kartave te identitetit dhe pasaportave biometrike si dhe leximin e kodit MRZ te ketyre dokumenteve duke bere te mundur vertetimin e faktitit e falcifikimit te tyre.

12 sistemet per identifikim, manexhim dhe kerkimin biometrik (te gjurmeve te gishtave dhe imazheve te fytyres) do te instalohen ne strukturat perkatese policore ku kryhen procedurat per personat e ndaluar/arrestuar.

Sistemet duhet te jete një zgjidhje e avancuar për marrjen e të dhënave biometrike, duke përfshirë pesë fotografi të fytyrës, një fotografi të plotë të trupit (në këmbë), si dhe regjistrimin e tatuazheve, gjurmeve te duarve dhe të zërit të personit të ndaluar/arrestuar.

Sistemet duhet te jene te përbëre nga:

Një bazë e fortë çeliku e pajisur me kolona mbështetëse;

Njësi optike e dedikuar me ndriçim LED të integruar për marrjen e fotografive;

Një karrige e motorizuar me sistem rrotullimi dhe ulje ngritje e komanduar;

Sfondi fotografike me ndriçim të vazhdueshëm LED;

Një sistem ndriçimi LED adaptueshem;

Hapsirë e dedikuar për vendosjen e PC-së, pajisjeve shtesë dhe kablllove;

Një ekran me prekje për kontrollin e sistemit fotografik;

Mjete të bazuara në Inteligjences Artificiale për asistencë dhe mbështetje të aktiviteteve të operatorit;

Aneksi i modulit për marrjen e gjurmëve të gishta me rregullim elektronik;

Një pajisje për kapjen e tatuazheve;

Një kit për regjistrimin e zërit;

Nje paisje Live Skaner per marrjen e gjurmeve te duarve;

Përmes softuerit perkates, njësia qendrore e kontrollit duhet te kryeje operacionet e mëposhtme:

Kontroll automatik cilësor i fotografive;

Marrje automatike e fotografive;

Transmetim i të dhënave në bazat e të dhënave qendrore (sistemet e Policise se Shtetit AFIS, AMAIS);

Marrje, menaxhim, transmetim dhe printim i gjurmëve të gishtave;

Rregullim automatik i lartësisë së subjektit të fotografuar: ngritje/ulje dhe rrotullim i karriges bazuar në detektimin dhe pozicionimin e syve;

Menaxhimi i ekranit të kontatorit dixhital;

Monitorim në kohë reale i pozicionimit korrekt të subjektit;

Ndërrim automatik i sistemit të ndriçimit (ndezje/fikje);

Ndërrim automatik i kamerës/pajisjeve fotografike (ndezje/fikje);

Printim i raporteve dhe kartave të identifikimit fotografik në formate të ndryshme standard.

Import/Export i skedarëve NIST për shkëmbim të dhënash me Forcat e tjera të Policisë dhe/ose Agjenci Ndërkombëtare.

Keto sisteme do të jenë të konceptuara si poste pune në Drejtorite Vendore të Police dhe Komisaritet të Policisë në vende, ku do të përgatitet një karte për regjistrimin penal ku do të pasqyrohen të dhënat e mëposhtme, për personat e ndaluar/arrestuar.

a- Të dhënat alfanumerike sëbashku me numrin e regjistrimit kriminal.

b- Informacioni për përgatitjen e kartës daktiloskopike me gjurmët papilare të 10 gishtërave dhe të gjurmëve të pellemëve të duarve, si me rrotullim ashtu dhe me imazhe të sheshta.

c- Fotografite sinjalitike (ballore dhe profil djathtas);

d- Katër imazhe frontale të personit: fytyrën, flokët, sytë, hundën dhe gojën, për të krijuar një bazë të dhënash fotografike për të rindërtuar një identikit;

e- Imazhet e të gjithë tatuazheve që personit ka në pjesët e trupit si fytyrë, në qafe, në duar, në parakrah, në krah, në shpatull, në këmbë, në kërci, në kokshe etj;

f- Përshkrimi i figurës së përshkruar;

g- Mostren e zërit human;

Fotografite

Fotografia do të duhet të merret me kushte identike të dritës, distancës dhe pozicionit. Fotografia do të realizohet duke shtypur një buton në sistem duke realizuar një fotografi ballore dhe profil djathtas që shihet njëkohësisht në ekran.

Fotografitë mund të merren në format dixhitale. Nga fotografia, operatori duke përdorur sistemin, mund të tregojë pika të ndryshme që ju japin informacionin e mëposhtëm në disa sekonda:

1) Antropometria e fytyrës së personit që është duke u fotografuar, i dobishëm për krahasime me imazhe të cilësisë së dobët (marrë në vende publike).

2) Një llogaritje vizuale e fytyrës së personit.

3) Katër imazhe frontale të personit: fytyrën, flokët, sytë, hundën dhe gojën, për të krijuar një bazë të dhënash fotografike për të rindërtuar një identikit.

4) Lista e tipareve të fytyrës: fytyra e gjatë, baza e hundës e ngritur, hunda e shkurtër, sytë e hapur, etj.

Operatori mund të verifikojë saktësinë e fotografive, përpara se t'i dërgojë në qendrën AMAIS.

Kur i dyshuari do të ndalohet/arrestohet, operatori shënon të dhënat personale të personit, numrin e regjistrimit kriminal, bën fotografinë dhe menjëherë sistemi krijon informacion për të ushqyer bazën e të dhënave qendrore, për të verifikuar nëse personi është identifikuar më parë (afërsisht 6 sekonda me një bazë të dhënash).

Sisteme për identifikim, menaxhim dhe kërkimin biometrik te instaluar ne strukturat përkatëse policore për personat e ndaluar/arrestuar është parashikuar qe te instalohen ne vende, sipas tabelës se mëposhtme:

Nr.	Emertimi I paisjes	Sasia	Struktura ku do te perdoren paisjet											
			DVP. TR	DVP. DR	DVP. SH	DVP. KU	DVP. DI	DVP. GJ	DVP. LE	DVP. EL	DVP. KO	DVP. FR	DVP. VL	DVP. BR
1	Sisteme per identifikim,manexhim dhe kerkim bimetrik.	12	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1

Me qëllim të marrjes së imazheve të tatuazheve me cilësi të lartë dhe të klasifikimit të tyre, duhet te kete një pajisje periferike SMT CAM (Shenja, Nishane dhe Tatuazhe). Kjo pajisje për marrjen e tatuazheve duhet te jetë një zgjidhje hardware dhe software e ndërfaqësuar me sistemin e fotografimit.

Pajisja duhet te lejoje marrjen e imazheve të tatuazheve me cilësi të lartë, duke ruajtur shkallën dimensionale të tyre.

SMT CAM duhet te jete e pajisur me:

- Kamera Full HD jo me pak se 12MP;
- Set dritash LED për ndriçim;
- Menaxher i shkallës dimensionale;
- Ekran me prekje jo me pak se 4’’ i orientueshëm;
- Aplikacion për mbledhjen dhe klasifikimin e imazheve;
- Sistem komunikimi drejt/nga sistemet për identifikim, menaxhim dhe kërkimin biometrik.

Kompleti per fotografimin e gjithe trupit duhet te përfshije një kamera Full HD jo me pak se 12MP dhe një stend të lëvizshëm, i përdorshëm për sfondin, në mënyrë që të sigurohet një imazh i subjektit në këmbë mbi një sfond homogjen, me ton gri.

Foto mund të merret përmes softuerit përmes ekranit me prekje, ndërsa, nëse aktivizohet modaliteti automatik, fotoja do të merret automatikisht nga sistemi, vetëm nëse plotësohen të gjitha kërkesat (ndriçimi, distanca, pozicionimi i subjektit).

Qëllimi i integritit te paisjes live skaner per marrjen e gjurmeve te gishtave ne sistemet per identifikim, manexhim dhe kerkim biometrik është për:

Identifikimin e shpejtë i të gjithë të ndaluarve/arrestuarve, personave të deportuar, emigrantet e paligjëshme me anan e gjurmëve të gishtave në sistemin ekzistues Afis/Apis.

Krahasimi automatik ne sistemin Afis/Apis të gjurmëve të duarve të personave të ndaluar/arrestuar, personave deportiv me qëllim për identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve që janë administruar si prova shkencore në çeshtjet penale në hetim apo të pezulluara.

Identifikimin e menjëherësh me gjurmët e gishtave të të gjithë personave që jane shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalim Kontrollit.

Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin Afis/Apis të imazheve të gjurmëve të duarve që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim identifikimi të autorit me anën e gjurmëve të gishtave në databazën e këtij sistemi brenda ditës.

Krijimin e mundësisë për të kaluar në krahasimin automatik të të dhënave daktiloskoipike midis sistemi tonë Afis/Apis dhe sistemeve të 10 vendet anëtare të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Europës Juglindore (PCC SEE) si Austria, Hungaria, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë Hercegovina dhe Moldavia.

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Ministrisë Brendshme të Shqipërisë, Ministrisë të Drejtësisë të Shqipërisë dhe ACRO-s të Anglisë “Për shkëmbimin e të dhënave për personat shtetas shqiptar dhe angleze të dënuar në Angli dhe Shqipëri” të nënshkruar tashme nga institucionet e mësipërme, është parashikuar që nga ACRO për çdo person shtetas shqiptar që arrestohet në Angli të dërgohen në rrugë elektronike në formatin NIST pranë Sektorit të Daktiloskopisë të Institutit të Policisë Shkencore gjurmët e gishtave të tyre me qëllim që brenda një kohe sa më të shpejtë, të bëhet krahasimi i këtyre gjurmëve të gishtave me të gjithë databazën e sistemi Afis të Policisë Shtetit dhe ti kthehet përgjigje në rast identifikimi të personin me emër të njëjtë apo me emër të ndryshuar me qëllim evidentimin në Ministrinë e Drejtësisë së faktin që ky shtetas shqiptar është i dënuar apo jo në Republikën e Shqipërisë.

Avantaxhet e këtij nderveprimi nga keto sisteme do të jenë:

Në të gjitha 12 vendet ku do të instalohen sistemet në Policinë e Shtetit që kryejnë procedurat për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar, deportiv dhe emigrant me problem në kufi dhe territor do të komunikojnë njësoj pavarësisht distancave.

Gjurmët e gishtave do të jenë me cilësi dhe rezolucion të lartë duke sjell identifikim të shpejt dhe të sigurt të personave.

Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin AFIS/APIS nga çdo Drejtori e Komisarariat Policie apo vendet e huaja partnere të imazheve të gjurmëve papilare që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e ngjarjeve(kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim krahasimin e tyre me gjurmët e duarve të databazës me qëllim identifikimin e tyre.

Funksionaliteti.

Njësia qendrore e kontrollit, përmes softuerit përkatës, kryen operacionet e mëposhtme:

-Marrjen e gjurmëve të duarve (gjurmët e 10 gishtave me rrotullim, gjurmët e pëllëmbëve, gjurmët e kontaktit të të 10 gishtave të dy duarve në formatin (4+4+2).

-Kontrollin me anën e dy gjurmëve të gishtave në data bazën e sistemit Afis Papillon 9 për të përcaktuar nëse personi i ndaluar/arrestuar ka patur me datat bazë kartele të mëparshme daktiloskopike apo jo.

-
- Vërtetimi i procesit të marrjes të fotografisë;
 - Transmetimi i të dhënave në bazat e të dhënave qendrore;
 - Marrja, menaxhimi, transmetimi dhe printimi i fotografive;
 - Vetë-rregullimi i lartësisë së fotografuar (ngritje automatike / ulje e automatike e karrige në lidhje me sytë e personit dhe pozicionimin e tyre);
 - Menaxhimi i ekranit të numëruesit;
 - Kontroll në kohë reale për pozicionimin e saktë të subjektit;
 - Ndezja / çaktivizimi automatik i sistemit të ndriçimit;
 - Ndezja / fikja automatike e kamerës / kamerës;
 - Shtypja e raporteve, raporteve dhe raporteve të veprimtarisë.

Specifikimet teknike.

Njësia qendore e kontrollit PC (karakteristikat minimale të kërkuara);

Cpu: Intel i5 ose më e lartë ose ekuivalente

Sistemi Operativ: Windows 11 Pro ose version më i lartë

RAM: 16 GB ose më shumë

Hard disk: SSD M.2 1 TB ose më i madh

Kartë grafike: 1port VGA, 1 port HDMI

Kartë audio: 5.1 kanale Audio I / O Portet x 1 (Linja në, Linjë-dalje, Mik-në)

Network Interface: 1 port LAN 10/100/1000 Mbps, e integruar

Porta USB 2.0: Nr. 2 ose më shumë

Porta USB 3.0: Nr. 2 ose më shumë

Njësi furnizimi e pandërprerë (UPS): 1200 VA ose më e lartë

Printer Laser i certifikuar nga FBI: Rezolucioni: 1200X1200 DPI

Monitori: 24'' LCD ose më i madh, Rezolucioni: 1280 × 1024

Skaner i sheshte për dokumente certifikuar nga FBI. Rezolucioni 6400 X 9600 dpi

- Paisje Live skaner për kapjen e imazheve të gjurmëve të gishtave duhet të jete me rezolucion jo me pak se 500 dpi.

-Interface USB 2.0

-Zona e kapjes së imazhit jo me pak se 132 x 130mm

-Zona e kapjes së imazhit për gjurmët e gishtave me rrotullim ose me prekje jo me pak se 42x41 mm;

-
- Zona e kapjes se imazhit për gjurmët e sheshta te 4 gishtave 132 x 130mm;
 - Zona e kapjes se imazhit për gjurmët e pëllëmbëve 132 x 130 mm;
 - Kapja e imazheve me sekuence: gjurme me kontakt (4+4+2), gjurme e gishtave me rrotullim, gjurmët e gishtit me kontakt dhe gjithë gjurmën e pëllëmbës se dorës;
 - Koha e skanimit jo me madhe se 5 sekonda, për gjurmët me kontakt jo me shume se 3 sekonda;
 - Cilësia e imazhit ne akordance me specifikimet teknike te cilësisë te imazhit te certifikuar nga FBI amerikane te certifikuar ne 2010;
 - Softueri te jete ne gjendje qe te krijojë kartelën daktiloskopike me gjurme e duarve sipas kërkesave te sistemit AFIS Papillon 9;
 - Softuer për kërkimin dhe automatik me anën e dy gjurme te gishtave ne data bazën e sistemit Afis Papillon 9 te Policise se Shtetit;

Karrigia e qëndrimit.

Karrigia ngrihet dhe ulet përmes një motori ingranazhi, e kontrolluar automatikisht nga software-i, i cili detekton pozicionin e syve të subjektit të ulur pa kërkuar ndërhyrje nga përdoruesi, duke garantuar që lartësia e karriges të jetë optimale për kapjen e imazheve të fytyrës me cilësi të lartë. Përmes ndërfaqes së software-it, operatori mund të rregullojë manualisht lartësinë e karriges nëse dëshiron.

Pesha maksimale e ngritjes së karriges së motorizuar: deri ne 200 kg.

Karrigia duhet te jete e pajisur me një shufër të fiksuar (por e heqshme kur është e nevojshme) me një mbështetës koke të rregullueshëm (për subjekte me lartësi nga 120 cm deri në 210 cm), për të mbajtur kokën e subjektit të fotografuar në një pozicion të përcaktuar, duke siguruar qëndrimin e duhur të fytyrës. Mbështetësi i kokës mund të rregullohet përpara dhe mbrapa sipas nevojës.

Karrigia duhet te jete e aftë të rrotullohet automatikisht për të kapur imazhet e fytyrës sipas rendit të përshkruar më parë, në mënyrë që subjekti të qëndrojë i palëvizur në pozicionin e duhur mbi karrige.

Njesia e ndricimit.

Sistemi i kërkuar duhet te jete i pajisur me një grup ndriçimi të integruar, i cili optimizon cilësinë e imazheve të kapura. Imazhet e prodhuara duhet të jenë njëtrajtësisht të ndriçuara, pa hije (si për sfondin ashtu edhe për personin), me ngjyrat natyrale të fotografisë dhe me eliminimin e efektit “sy të kuq”.

Grupi i ndriçimit është pjesë integrale e sistemit dhe mundëson marrjen e fotografi-ve pavarësisht nga kushtet e ndriçimit në dhomën ku do të vendoset.

Grupi i ndriçimit përbëhet nga nën-sisteme ndriçimi për marrjen e imazheve të fytyrës, të organizuara si më poshtë: dritë frontale e sipërme, dritë e djathtë e sipërme, dritë frontale e poshtme, dritë përmbushëse e poshtme, dritat anësore të afërsisë/përmbushjes (djathtas dhe majtas), dritë për imazhin e trupit të drejtë, dritë përmbushëse e sfondit; të gjitha të përzgjedhura dhe të aktivizuara automatikisht në varësi të tipit të imazhit që do të kapet.

I gjithë sistemi i ndriçimit përbëhet nga module LED të furnizuara me energji 24V DC. Për të garantuar një ndriçim uniform dhe mungesë hije, më poshtë paraqiten karakteristikat e çdo pajisjeje ndriçuese:

Dritë frontale e sipërme:

- Fluks maksimal dritëlëshues: jo me pak se 3200 lm (2×1600 lm)
- Temperatura e ngjyrës: 5000~6500 K
- Fuqia maksimale: jo me pak se 24 W

Dritë e sipërme e djathtë:

- Fluks maksimal dritëlëshues: jo me pak se 3200 lm (2×1600 lm)
- Temperatura e ngjyrës: 5000~6500 K
- Fuqia maksimale: jo me pak se 24 W

Dritë frontale e poshtme dhe dritë për të gjithë trupin:

- Fluks maksimal dritëlëshues: jo me pak se 1600 lm
- Temperatura e ngjyrës: 5000~6500 K
- Fuqia maksimale: jo me pak se 12 W

Dritë plotësuese e poshtme:

- Fluks maksimal dritëlëshues: jo me pak se 900 lm
- Temperatura e ngjyrës: 5000K~6500K
- Fuqia maksimale: jo me pak se 6W

Dritë sfondi dhe afërsie (4 segmente):

- Fluks total dritëlëshues: jo me pak se 2600 lm
- Fuqia nominale totale: jo me pak se 18W

Intensiteti i dritës mund të rregullohet automatikisht nga software-i.

Pas karriges së motorizuar ndodhen panele sfondi për fotografi, të përbëra nga sipërfaqe sfondi të përdorura në të gjitha fotografitë e fytyrës (frontale dhe $\frac{3}{4}$) dhe një sfond i palosshëm për marrjen e imazheve të trupit të tërë. Sipërfaqet duhet të jenë gri e hapur (RAL 7035) me veshje specifike jo-reflektuese.

Njesia optike dhe fotografike.

Çdo sistem duhet të jetë i pajisur me një njësi optiko-fotografike të integruar, e cila përfshin kamera, objektiva, prizma dhe pasqyra të përshtatshme për realizimin e fotografive.

Kamerat duhet të jenë me rezolucion të lartë (jo me pak se 12 megapiksel) dhe të jenë të konfiguruar automatikisht, në mënyrë që operatori të mos ketë nevojë të rregullojë asnjë parametër. Optikët duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe dorëzohen të montuara plotësisht dhe të kalibruara paraprakisht.

Fotografitë e prodhuara nga sistemi duhet të jenë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare ISO/IEC JTC 1/SC 17 – Cards and Security Devices for Personal Identification (veçanërisht WG3 – Identification Cards / MRTD – Machine Readable Travel Documents), ISO/IEC 19794-5, si dhe me standardet ICAO dhe me praktikën më të mira të përdorura në procedurat e fotografimit identifikues policor.

Imazhet e përftuara duhet të plotësojnë kërkesat teknike të mëposhtme:

Sfond neutral i ndriçuar, i pozicionuar në një distancë minimale prej ≥ 20 cm nga subjekti, i përdorur si për fotografitë ballore ashtu edhe për ato anësore (profil);

Ndriçim homogjen i fytyrës, i projektuar për të garantuar mungesën e plotë të hijeve si në fytyrën e subjektit ashtu edhe në sfond;

Camera Subject Distance (CSD), pra distanca minimale ndërmjet subjektit dhe planit të kapjes së sensorit fotografik, e barabartë me 180 cm, me optikë ekuivalente 80 mm (formati 35 mm full-frame), për sigurimin e proporcioneve korrekte biometrike.


Kamerat fotografike duhet të përmbushin parametrat teknikë të mëposhtëm:

Objektiv 16 mm mbi sensor 1/2.3", ekuivalent me 90 mm në sensor 35 mm (full-frame);

Fusha e Pamjes (Field of View – FOV) diagonale, e përfshirë ndërmjet 26° dhe 28°

Distanca minimale interokulare (ndërmjet qendrave të syve): ≥ 300 piksel;

Raporti i kornizimit për pamjen ballore dhe profil, i nevojshëm për procedurat e fotosenjalimit (shih figurën): $A \geq 300$ mm, $B \geq 400$ mm.



Imazhet do të duhet të ruhen në formatet NIST, JPEG dhe BMP (me cilësi të përzgjedhshme gjatë fazës së konfigurimit të sistemit).

Të gjitha fotografitë duhet të merren në modalitet të automatizuar, me rregullimin automatik të të gjithë parametrave drejtpërdrejt nga sistemi, pa qenë e domosdoshme ndërhyrja e operatorit. Megjithatë, operatorit i lejohej të modifikojë manualisht parametrat, si p.sh. dimensionet e imazhit, faktorin e kompresimit, formatin e imazhit dhe parametra të tjerë teknikë.

Specifikimet teknike për 30 pajisjet portable të identifikimit biometrik dhe kontrollit të dokumentave të identifikimit personal (ID dhe pasaporta biometrike)

Keto pajisje do të duhet lidhet on-line me dy sistemet e Policisë Shtetit për identifikimin biometrik të personit, sistemin e identifikimit të fytyrës AFAIS si dhe me sistemin e identifikimit të gjurmëve të gishtave AFIS, nëpërmjet rrjetit IT të Policisë së Shtetit, falë instalimit të softuerit

të komunikimit dhe do të duhet të analizojnë të dhënat dhe elementët e sigurisë në dokumentet e identifikimit, pasaporta, viza të ndryshme hyrëse, dokumente udhëtimi, kartëmonedha etj.

Kjo pajisje do të duhet të analizojë elemente sigurie që kanë databazën e tyre, duke përdorur sensorë dixhital për leximin e tyre nga chip-i RFID, duke identifikuar personin me të dhënat biometrike të fytyrës të ruajtur në chip, identifikimin e personit me anën e gjurmëve të gishtave të ruajtura në chip, leximin e kodit ICAO (MRZ), si dhe leximin e elementëve të sigurisë të këtyre dokumenteve duke përdorur të dhënat e specimenëve të ruajtura në kartën e memories së pajisjes, e cila do të ketë një kapacitet ruajtje të informacionit deri të paktën 1 TeraByte.

Këto pajisje do të duhet të jenë kompatibël me çdo lloj telefoni SMART të gjeneratës së fundit, duke bërë të mundur kqyrjen e dokumenteve nëpërmjet një aplikacioni dhe lidhjen me databazën për të krahasuar këto dokumente me specimenet e ruajtura aty. Informacioni në kartën e memories do të ketë të gjitha elementet e sigurisë të dokumenteve të udhëtimit nga sa me shume shtete të botës, jo me pak se 100 shtete.

Pajisjet portabël do të duhet të kryejnë analizën biometrike të informacionit të ruajtur në kodin ICAO (MRZ), të gjurmëve të gishtave të personit me imazhin e gjurmëve të gishtave të ruajtura në chip-in e dokumentit, si dhe të imazhit të fytyrës 1 me 1 me të personit që është posedues i pasaportës apo dokumentit të identifikimit.

Po kështu, ato duhet të bëjnë dhe kërkimin e ngjashmërisë së imazhit të fytyrës në databazën e sistemit AFAIS dhe nëse ka përputhshmëri, ky informacion do të shfaqet në % se sa përputhshmëri ka midis objektit që ekzaminohet me modelin në databazën qendrore.

Po kështu, ato do të duhet të bëjnë edhe kontrollin e identitetit të personit me anën e gjurmëve të gishtave në kohë reale në databazën e të dhënave të sistemit AFIS. Rezultatet e kërkimeve merren përsëri në terminal ku përfshihen të gjitha informacionet e hollësishme të lidhura me individin që gjendet në bazat e të dhënave të kartelave daktiloskopike dhe galeritë e portreteve të fytyrës.

Kështu, për shembull, kur një oficer fillon kontrollin e një individi për identifikimin me gjurmë gishtash, ai merr përsëri në terminalin portabël të gjitha informacionet nga të gjitha regjistrimet e krijuara ndonjëherë për këtë individ (emri, vendi marrjes së gjurmëve të gishtave, data e marrjes të gjurmëve të gishtave dhe Komisarariatit i Policisë ku janë marrë gjurmët papilare, numrin e regjistrimit kriminal).

Specifikimet teknike për pajisjet portable.

Pajisja portabël do të ketë një dhomë të vogël të errët me një zmadhues optik dhe llambë të integruar për të lejuar katër mënyra ndriçimi të kontrollueshme nga përdoruesit:

- Dritë e bardhë (W); - Dritë ultra vjollcë (UV); - Dritë infra e kuqe (IR); - Dritë me kënd (GR); - Dritë e pasme për kontrollin e filigranit dhe fijeve së sigurisë.

Mënyrat e ndriçimit do të përdorin kombinim me një smartphone ose tabletë të zakonshëm, duke mundësuar lejimin e ekzaminimit të:

- Printime mini dhe mikro.
- Printime me gdhendje ose lazer.
- Fijet e sigurisë.
- Watermark filigranit.
- Provat që nuk mund të zbulohen me sy të lirë.
- Bojë foto-sensitive (si në IR ashtu edhe me UV).
- Elementë foto-sensitivë si mikro-fibër dhe foto.
- Printime të larta dhe të lehta.

Pajisja do të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Lexues i gjurmëve të gishtave live skaner me rezolucion te pakten me 500dpi.
- Pajtueshmëria me formatin ANSI 378 dhe ISO 19794
- Cilësia e figurës në përputhje me FIPS 201-PIV
- Kompresimi i figurës së gjurmës së gishtit WSQ
- Lexues i NFC / RFID
- Lexuesi i të dhënave të ICAO-MRZ
- Auto-identifikimi i dokumenteve elektronike të identitetit (lexues të të dhënave EAC dhe BAC)
- Funksione në lidhje me një smartphone ose tabletë të aftë për NFC
- Lidhshmëri me USB
- Analizë vizuale multi-spektrale (dritat e bardha, ultra vjollcë, infra të kuqe dhe me kënd)
- Mini-dhomë e errët për të garantuar izolimin nga drita e ambientit.
- Lentet e zmadhimit lejojnë analizën e makro dhe mikro-printimeve
- Filtrat (Greyscale, Negativ, 3M)

-
- Qasja në bazën e të dhënave të dokumenteve të identitetit të mostrave.
 - Bateri Li-Po jo me pak se 6600mAh e rikarikueshme,
 - Autonomia operative: jo me pak se 8 orë.

Specifikimet teknike për instalimin e platformës elektronike për lidhjen me pajisjet portabël .

Kjo platformë do të përfshijë: a) Pajisjet, b) Softuerin, c) Shërbimet.

Arkitektura e përgjithshme.

Platforma do të jetë një sistem kompleks dhe i aftë për të gjeneruar një komunikim dypalësh me një server aplikacioni.

- Aplikacioni : Ky aplikacion është sistemi operativ për pajisjet portable.

- Aplikacioni do të lejojë hyrjen në të gjithë platformën.

- Databaza e ekzemplarit (modelit): do të jetë një modul softueri që bashkëvepron me pajisjen dhe mbështet operatorët gjatë vlerësimit të dokumentit.

Databaza ruan të gjitha informacionet në lidhje me veçoritë e dokumenteve së bashku me të dhënat e lidhura dhe procedurat e kontrollit.

- Kontrolluesi i Procedurave të Arkivit: është modul softuer i dedikuar për të menaxhuar procedurat e kontrollit të dokumenteve.

Sa herë që një dokument kontrollohet nga një operator, krijohet një procedurë e re. Ky modul luan një rol të rëndësishëm në platformë.

- Porta e të dhënave: është softuer i dizenuar për të kryer qasje në burimet e të dhënave të jashtme nga platforma dhe për të arritur shërbime të tjera. Aplikacioni i komunikimit midis sistemit portabël dhe shërbimit të jashtëm Aplikacioni i komunikimit do të jetë një aplikacion i bërë për tu ekzekutuar në një smartphone android dhe që punon në lidhje me një pajisje Smart.

Aplikacioni do të duhet të lejojë të konsultohen të dhënat e përfshira në bazën e të dhënave të specimeneve, përfshirë shënime, element interesi dhe të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në lidhje me dokumentin ose kartëmonedhën e dhënë.

Aplikacioni i komunikimit do të duhet të lejojë kapjen e imazheve duke përdorur kamerën e instaluar në smartphone, do të ketë filtra të ndryshëm si shkalla gri ose negative për të marrë rezultatin e dëshiruar. Aplikacioni i komunikimit do të lejojë të përdoren këto funksione:

- Analiza vizuale
- Shikimi i të dhënave ICAO-MRZ
- Shikimi i të dhënave ICAO-IMAGE
- Skanimi dhe kontrolli i gjurmëve të gishtave ICAO-MRZ

Shikuesi i të dhënave.

Ky funksion do te duhet te lejojë operatorëve të pajisjes portabël të lexojnë një kod MRZ të shtypur në një pasaportë duke përdorur lexuesin MRZ të inkorporuar në pajisjen portabël.

ICAO-IMAGE Shikuesi i të dhënave.

Fotografia e ruajtur në një e-pasaportë elektronike do të lexohet me këtë funksion.

Skanimi i gishtave dhe lexuesi i tyre.

Përdorimi i këtij funksion do të lejojë skanimin dhe shikimin e një gjurme gishti duke përdorur lexuesin e gjurmëve të gishtërinjve të instaluar në pajisjen portabël.

Databaza e specimenit.

Komponenti i softuerit do të krijojë, ruajë dhe marrë informacione për të ndihmuar në analizën vizuale të drejtuar dhe manuale përmes aplikacionit të komunikimit.

Databaza përbëhet nga burimet e mëposhtme:

- Imazhe të dokumenteve dhe të kartëmonedhave, duke shfaqur të gjithë artikullin dhe detajet e tij.

Paisja duhet te kete karakteristikat e meposhteme:

- Lexues i gjurmeve te gishtave me 500 dpi fap30.
- Pajtueshmëria me formatin ANSI 378 dhe ISO 19794
- Cilësia e figurës në përputhje me FIPS 201-PIV
- Kompresimi i figurës së gjurmës së gishtit WSQ
- Lexues i NFC / RFID
- Lexuesi i të dhënave të ICAO-MRZ
- Autoidentifikimi i dokumenteve elektronike të identitetit (lexues të të dhënave EAC dhe BAC)
- Funksione në lidhje me një smartphone ose tabletë të aftë për NFC
- Lidhshmëri me USB
- Analizë vizuale multispectrale (dritat e bardha, ultra vjollcë, infra të kuqe dhe me kend)
- Mini dhomë e errët për të garantuar izolimin nga drita e ambientit.
- Lentet e zmadhimit lejojnë analizën makro dhe mikro printime
- Filtrat (Greyscale, Negativ, 3M)
- Qasja në bazën e të dhënave të dokumenteve të identitetit të mostrave të 138 ishte përmes APP për Android: EFAD
- Bateri Li-Po jo me pak se 6600 mAh i rimbushëm
- Autonomia operative: jo me pak se 8 orë
- Bateria Stand-by Time: jo me pak se 7 ditë

Instalimi i platformes elektronike per lidhjen me pajisjet portabile.

Kjo platforma duhet te përfshije:

a) Pajisjet, b) Softuerin, c) Shërbimet.

Arkitektura e përgjithshme.

Platforma është një sistem kompleks dhe e afte për të gjeneruar një komunikim dypalësh me një server aplikacioni.

-Aplikacioni eFAD: Ky aplikacion është sistemi operativ për pajisjet portabile.

-Aplikacioni eFAD duhet te lejoje hyrjen në të gjithë platformën FAD.

-Aplikacioni eFAD duhet te lejoje hyrjen në shërbime të tjera të tilla si zyra e kompetences dhe porta e të dhënave.

-Databaza e ekzemplarit: është një modul softueri që bashkëvepron me pajisjet dhe mbështet operatorët gjatë vlerësimit të dokumentit. Databaza ruan të gjitha informacionet në lidhje me veçoritë e dokumenteve së bashku me metadatat e lidhura dhe procedurat e kontrollit. Databaza e ekzemplarit mund të konsiderohet zemra e platformës .

-Kontrolluesi i Procedurave te Arkivit: eshte modul softueri i dedikuar për të menaxhuar procedurat e kontrollit të dokumenteve. Sa herë që një dokument kontrollohet nga një operator, krijohet një procedurë e re. Ky modul luan një rol të rëndësishëm në platformë.

-Porta e të dhënave: eshte softuer i dizajnuar për të kryer qasje në burimet e të dhënave të jashtme nga platforma dhe për të arritur shërbime të tjera.

Aplikacioni eFAD

Aplikacioni eFAD është një aplikacion i bërë për të ekzekutuar në një smartphone android dhe punon në lidhje me një pajisje Smart. Aplikacioni duhet te lejoje të konsultoni të dhënat e përfshira në bazën e të dhënave të ekzemplarëve, përfshirë shënime, element interesi dhe të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në lidhje me dokumentin ose kartëmonedhën e dhënë. Aplikacioni eFAD duhet te lejoje kapjen e imazheve duke përdorur kamerën e instaluar të smartphone, te kete filtra të ndryshëm si shkalla gri ose negative për të marrë rezultatin e dëshiruar.

Te dhenat.

Aplikacioni eFAD duhet te lejoje të përdorni këto funksione:

-Analiza vizuale.

-Shikimi i të dhënave ICAO-MRZ.

-Shikimi i të dhënave ICAO-IMAGE.

-Skanimi dhe shikimi i gjurmëve të gishtërinjve.

CAO-MRZ Shikuesi i të dhënave

Ky funksion lejon operatorët të lexojnë një kod MRZ të shtypur në një pasaportë duke përdorur lexuesin MRZ të ngulitur në pajisjen.

ICAO-IMAGE Shikuesi i të dhënave.

Fotografia e ruajtur në një e-pasaportë elektronike mund të lexohet me këtë funksion.

Skanimi i gishtave dhe lexuesi i tyre.

Përdorimi i këtij funksion duhet të lejoje skanimin dhe shikimin e një gjurmë gishti duke përdorur lexuesin e gjurmëve të gishtërinjve të instaluar në pajisjen.

Databaza e specimenit.

Komponenti i softërit duhet të krijojë, ruajë dhe marrë informacione për të ndihmuar në analizën vizuale të drejtuar dhe manuale përmes eFAD App.

Databaza përbëhet nga burimet e mëposhtme:

- Imazhe e dokumenteve dhe të kartëmonedhave, duke shfaqur të gjithë artikullin dhe detajet e tij.
- Përshkrimi dhe shënimet.

Përshkrimet e dokumentit për të ndihmuar operatorin të kuptojë dokumentin e analizuar.

Procedurat e analizës pamore.

Dokument i ruajtur në depo është i lidhur me një procedurë që i lejon operatorit të zbulojë një dokument të falsifikuar duke minimizuar kontrollet e nevojshme.

Funksionet administrative duhet që të lejojnë të administroni, azhurnoni dhe menaxhoni pajisjet.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Pajisje multifunksionale për mbledhjen biometrike të personave	12	QENDRES SE FUNIZIMIT MATERIAL O-TEKNIK- MULLET	të paktën pas 2 muajve nga nënshkrimi i kontratës por jo me vonë se java e fundit e muajit Dhjetor 2026
2	Pajisje portabile të identifikimit të personit me anën e gjurmëve të gishtave dhe fytyrës humane	30	QENDRES SE FUNIZIMIT MATERIAL O-TEKNIK- MULLET	të paktën pas 2 muajve nga nënshkrimi i kontratës por jo me vonë se java e fundit e muajit Dhjetor 2026

Afatet e lëvrimit:

Afati levrimit është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor dhe do të jetë të paktën pas 2 muajve nga nënshkrimi i kontratës por jo me vonë se java e fundit e muajit Dhjetor 2026.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerë së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

